

Çitaku: Komentet për
deklaratat e zyrtarëve
amerikanë duhet të bëhen
me shumë kujdes | F. 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

SPECIALJA RRËZON MOCIONIN E MBROJTJES NË RASTIN NDAJ LIDERËVE TË UÇK-së

| F. 3

- 'Historia e Kosovës nuk guxon të shkruhet
në sallat e heshtura të gjykatave'



LIRI PËR ÇLIRIMTARËT

Gjykata Speciale ka rrëzuar mocionin e mbrojtjes së liderëve të UÇK-së në të cilin kërkohet heqja e disa materialeve nga aktakuzat ndaj tyre. Mbrojtja kishte kërkuar të rrëzohen të gjitha akuzat për krimet apo incidentet e kryera para

majit të vitit 1998 dhe pas 20 qershorit 1999. Kryetari i trupit gjykues, Charles Smith, duke e arsyetuar vendimin e Speciales, ka sqaruar se incidentet e përmendura nga mbrojtja nuk konsiderohen akuza të veçanta, por pjesë përbërëse

e akuzave ekzistuese. Ndaj këtij vendimi të Speciales ka pasur reagime të shumta në Kosovë, duke quajtur këtë vendim zhgënjyes dhe arbitrar. Në këtë kontekst është kërkuar edhe reagimi i shtetit dhe nisja e protestave

**OSMANI: KOSOVA ËSHTË
DHE MBETET NJË
ALËATE E BESUESHME
NË MBROJTJE TË VLERAVE
DEMOKRATIKE** | F. 7



**SUPREMJA: NXJERRJA E
AKTEVE NËNLIGJORE NGA
MINISTRAT QË JANË
DEPUTETË SHKEL
DISPOZITAT KUSHTETUESE** | F. 3



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

SPORT



**DRITA KRENOHET ME SUKSESIN
HISTORIK, RAMADANI 'KERCENON'
EDHE COPENHAGENIN** | F. 10



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Trumpi: Disa raketa 'Patriot' janë tashmë rrugës për në Ukrainë

WASHINGTON, 16 KORRIK - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Donald Trump, ka bërë me dije se disa raketa kundërajrore për sistemin mbrojtës, "Patriot", janë tashmë rrugës për në Ukrainë, një ditë pasi ka njoftuar se vendet anëtare të NATO-s do të dërgonin armë në Ukrainë. Trumpi e ka ndryshuar qëndrimin e tij rishtazi, pasi më herët ishte kundër dërgimit të armëve amerikane në vendin e përfshirë nga lufta. "Ato po vijnë nga Gjermania", u ka thënë Trumpi gazetarëve, por pa dhënë më shumë hollësi.

Ministri i Mbrojtjes i Gjermanisë, Boris Pistorius, ka thënë se janë duke u bërë përgatitje për t'ia dorëzuar Ukrainës dy sisteme "Patriot".

Gjermania do të paguajë për dërgimin e tyre, por hollësitë përfundimtare teknike, logjistike dhe financiare ende nuk janë qartësuar, ka thënë Pistorius të hënën, pas takimit me sekretarin amerikan të Mbrojtjes, Pete Hegseth, në Pentagon.

Hollësitë "duken të zgjidhshme për të dyja palët, kështu që do ta fillojmë punën shpejt", ka thënë Pistorius, duke theksuar se Ukrainës i nevojiten urgjentisht sisteme shtesë të mbrojtjes ajrore.

Dronë rusë "Shahed" kanë sulmuar qytetin e Harkivit në mbrëmjen e së martës, duke plagosur dy njerëz, kanë raportuar autoritetet vendëse. Guvernatori rajonal Oleh Synyehubov ka thënë se të paktën 17 shpërthime u dëgjuan në qytet brenda 20



minutash.

Trumpi ka thënë se nuk ka folur me presidentin e Rusisë, Vladimir Putin, që nga dita e hënë, kur ka njoftuar se i kishte thënë afat prej 50 ditësh Rusisë ta pranojë një marrëveshje armëpushimi për

ta shmangur vendosjen e sanksioneve ndaj vendeve që bëjnë tregti me Rusinë. Trumpi nuk ka thënë nëse janë planifikuar bisedime për të arritur një marrëveshje, por mbrojtja afatin kohor. "Në fund të 50 ditëve, nëse nuk kemi një

marrëveshje, do të jetë shumë keq", ka thënë Trumpi. Por, ai, gjithashtu, ka shtuar se mund të mos nevojiten 50 ditë për të arritur një marrëveshje.

Trumpi është pyetur gjithashtu për një raport të gazetës "The Financial Times", sipas të cilit, ai e kishte nxitur privatisht Ukrainën t'i intensifikonte sulmet në thellësi të Rusisë.

Duke cituar burime të informuara mbi diskutimet, gazeta ka raportuar se Trumpi e kishte pyetur presidentin e Ukrainës, Volodymyr Zelensky, nëse ushtria ukrainase mund ta godiste Moskën nëse ShBA-ja do t'i jepte armë me rreze të gjatë veprimi.

"Jo, ai nuk duhet ta sulmojë Moskën", ka thënë Trumpi për gazetarët kur u pyet nëse Zelensky duhet të urdhërojë sulm mbi kryeqytetin rus.

Një vit e tetë muaj burgim për rivalin kryesor të Erdoganit në Turqi



Ankara, 16 korrik - Një gjykatë turke ka dënuar të mërkurën kryetarin opozitar të Stambollit, Ekrem Imamoglu, me një vit e tetë muaj burg për fyerje dhe kërcënim ndaj një zyrtari publik.

Imamoglu, rival kryesor i presidentit Rexhep Taip Erdogan, ndodhet në burg që nga 23 marsi dhe pritet të apelojë vendimin, raporton "AP".

Rasti lidhet me komentet e tij më 20 janar, ku ai kishte kritikuar prokurorin e përgjithshëm të Stambollit, Akin Gurlek, duke e akuzuar për hetime të motivuara

politikisht ndaj figurave opozitare.

Gjykata e ka shpallur Imamoglun fajtor për fyerje dhe kërcënim, por e ka liruar nga akuza për identifikim publik të zyrtarit me qëllim shënjestrim.

Imamoglu e ka mohuar fajësinë, duke e quajtur procesin "ndëshkim, jo drejtësi", dhe ka akuzuar gjyqësorin se vepron nën presionin e qeverisë. Ai është arrestuar bashkë me figura të tjera të Partisë Popullore Republikane, partia kryesore opozitare, si pjesë e një hetimi për korrupsion, arrestime që nxiten protestat më të mëdha në

Turqi në mbi një dekadë.

Pavarësisht se ndodhet në burg, Imamoglu është shpallur zyrtarisht kandidat presidencial nga Partia Popullore Republikane për zgjedhjet që pritet të mbahen në vitin 2028, por që mund të përshpejtohen. Që prej arrestimit të tij, dhjetëra zyrtarë të komunave të kontrolluara nga opozita janë përballur me arrestime për dyshime mbi manipulim tenderësh dhe rryshfet.

Opozita i ka quajtur këto akuza politike. Ndërkohë, qeveria e Erdoganit këmbëngul se gjykatat janë të pavarura dhe veprojnë pa ndikim politik.

Kina rikonfirmon normalizimin e raporteve me BE-në

PEKIN, 16 KORRIK - Autoritetet kineze kanë rikonfirmuar të mërkurën se do t'i normalizojnë raportet me Parlamentin Evropian (PE), teksa Pekini zyrtar ka për synim t'i thellojë raportet ekonomike e politike me Brukselin në mesin e tensioneve globale tregtare, ka raportuar "Reuters". "Vitet e fundit shkëmbimet ndërmjet trupave legjislativë të Kinës dhe Evropës janë përballur me disa pengesa për arsye që dihen shumë mirë", ka njoftuar Ministria e Jashtme e Kinës tek iu ka referuar pretendimeve për abuzime me të drejtat e njeriut në rajonin e Xinjiangut.

Nga Kina kanë thënë se është shumë e rëndësishme që të forcohet bashkëpunimi me Bashkimin Evropian (BE). "Në rrethanat e tanishme, të dyja palët besojnë se është shumë e rëndësishme që Kina dhe Evropa të përforcojnë dialogun dhe bashkëpunimin", ka thënë zëdhënësja Lin Jian, duke shtuar se Pekini zyrtar dhe Parlamenti Evropian kanë vendosur për të hequr të gjitha kufizimet sa iu përket shkëmbimeve të ndërsjella të ligjëvënësve.

Komentet nga Ministria e Jashtme e Kinës janë bërë pasi gazeta "South China Morning

Post" kishte raportuar se Pekini ka hequr "kufizimet" ndaj ish-ligjvënësit të BE-së, Reinhard Buetikofer.

Normalizimi i raporteve ishte konfirmuar paraprakisht nga Parlamenti Evropian dhe Kina në fillim të këtij viti.

Në marsin e vitit 2021 Kina i kishte vendosur 10 zyrtarë dhe 4 entitete evropiane në listë të zezë, si kundërpërgjigje për sanksionet e Brukselit ndaj zyrtarëve kinezë në Xinjiang. Komentet e së mërkurës janë realizuar gjithashtu përpara një samiti të liderëve Kinë-BE të planifikuar gjatë këtij muaji, ku presidentja e Komisionit



Evropian, Ursula von der Leyen dhe presidenti i Këshillit Evropian, Antonio Costa, pritet

të takohen me presidentin kinez Xi Jinping dhe kryeministrin Li Qiang në Pekin.

LDK-ja dorëzon vendimin e Supremes në Prokurorinë Speciale, kërkon hetim penal për qeverinë

PRISHTINË, 16 KORRIK - Deputetët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Besian Mustafa dhe Alban Zogaj, kanë dorëzuar në Prokurorinë Speciale të Kosovës vendimin e fundit të Gjykatës Supreme, që lidhet me çështjen e arkave fiskale. Sipas tyre, ky është një hap drejt “kërkimit të përgjegjësisë institucionale” për shkeljet ligjore nga qeveria në detyrë.

Deputeti Besian Mustafa ka thënë se aktgjykimi i Gjykatës Supreme konfirmon se

“kryeministri në detyrë dhe disa ministra kanë vepruar jashtëligjshëm pasi janë certifikuar si deputetë më 27 mars”. “Gjykata Supreme ka nxjerrë një aktgjykim ku konfirmon atë që ka thënë LDK-ja tash e disa muaj. Këtë aktgjykim e kemi bashkangjitur në dosjen tonë, ku kemi dorëzuar në muajin maj 17 kallëzime penale për ish-kryeministrin Kurti dhe ministrat e kabinetit të tij”, ka thënë ai.

Mustafa ka theksuar se nga

momenti i certifikimit të deputetëve ata nuk mund të ushtrojnë funksione në qeveri, ndërsa deputeti Alban Zogaj ka kërkuar nga Prokuroria Speciale që të ndërmarrë veprime konkrete. Zogaj ka theksuar se kanë dorëzuar edhe një dokument shtesë, duke kërkuar hetim penal ndaj ministrave që “mbajnë dy pozita”. “Prokuroria duhet të veprojë dhe kjo duhet të jetë sinjal që të zhblokohet situata”, ka thënë Zogaj.



SUPREMJA: NXJERRJA E AKTEVE NËNLIGJORE NGA MINISTRAT QË JANË DEPUTETË SHKEL DISPOZITAT KUSHTETUESE

PRISHTINË, 16 KORRIK - Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar se nxjerrja e akteve nënligjore apo udhëzimeve administrative nga ministrat që janë deputetë është e kundërligjshme dhe shkel dispozitat kushtetuese, duke nxitur kundërshtim të ashpër nga qeveria në detyrë. Supremja e ka shpallur të paligjshëm dhe e ka shfuqizuar një udhëzim administrativ të nxjerrë nga ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati.

Udhëzimi administrativ për shfrytëzimin e pajisjeve elektronike fiskale, sistemeve fiskale dhe softuerëve elektronikë fiskalë, ishte publikuar në gazetën zyrtare më 16 prill, një ditë pasi ishte miratuar nga ministri në detyrë, i cili është gjithashtu i betuar si deputet i legjislaturës së re pas zgjedhjeve të shkurtit. “Qeveria në dorëheqje është e autorizuar të kryejë vetëm aktivitetet e domosdoshme dhe të planifikuara në planin vjetor të punës së qeverisë dhe në ligjin vjetor për buxhetin, duke përfshirë miratimin e akteve nënligjore normative të reja”, ka njoftuar Supremja.

Ajo ka thënë se për të ishte “i pakontestueshëm fakti” se nga certifikimi zyrtar i rezultateve të



zgjedhjeve më 27 mars, ministri Murati figuron si deputet i Kuvendit të Kosovës. “Sipas nenit 71 të Kushtetutës, ushtrimi i funksioneve të deputetit dhe të ministrit në të njëjtën kohë është i ndaluar. Për pasojë, nxjerrja e Udhëzimit Administrativ nga një person që ushtron njëkohësisht detyrën e deputetit dhe të ministrit është e kundërligjshme dhe shkel dispozitat kushtetuese”, është thënë në vendimin e Supremes. Ndaj këtij vendimi ka reaguar qeveria në detyrë. Ajo ka theksuar se ndihet e

“shqetësuar” dhe se e kundërshton aktgjykimin e Gjykatës Supreme, duke cilësuar atë si “të pabazuar në ligj” dhe “arbitrar”. “Neni 31 i Ligjit për Qeverinë nuk përmban asnjë ndalesë lidhur me nxjerrjen e akteve nënligjore nga një qeveri në detyrë apo ministrat në detyrë. Ky nen kufizon veprimtarinë e qeverisë në detyrë vetëm në çështje madhore, si: marrëveshje ndërkombëtare që kërkojnë ratifikim në Kuvend, amendamente kushtetuese, projektligje të reja, strategji dhe

koncept-dokumente, por jo në nxjerrjen e akteve zbatuese, siç është Udhëzimi administrativ në fjalë”, është thënë në reagimin e qeverisë.

Ndërsa ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, e ka kundërshtuar këtë vendim, duke e cilësuar “absurd”. Në anën tjetër, vendimi i Gjykatës Supreme është mirëpritur nga ish-opozita dhe shoqëria civile. Sipas tyre, ky vendim ka “qartësuar përfundimisht” se ministrat, tashmë me mandat si deputetë, nuk mund të vazhdojnë të ushtrojnë funksione ekzekutive pas certifikimit të rezultateve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Ligji për Qeverinë parashikon se një qeveri në detyrë nuk mund t’i tejkalojë autorizimet e saj të kufizuara dhe ndalon marrjen e vendimeve madhore.

Gjykata Supreme i reagon qeverisë: Ndërhyrja në vendime gjyqësore është e papranueshme

Gjykata Supreme ka reaguar ndaj deklaratës akuzuese të

qeverisë në detyrë, duke e cilësuar atë si tendencioze dhe një ndërhyrje të papranueshme në pavarësinë e gjyqësorit. Supremja ka theksuar se komentet e qeverisë përbëjnë keqinterpretim të natyrës së vendimmarrjes gjyqësore dhe cenojnë legjitimitetin e saj. “Të gjitha institucionet, përfshirë qeverinë, janë të obliguara ta respektojnë pavarësinë e gjyqësorit si një nga themelet e rendit kushtetues”, është thënë në reagim. Supremja ka theksuar se ka vepruar në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi dhe pret që institucionet shtetërore t’i zbatojnë vendimet gjyqësore si kusht për funksionimin e shtetit të së drejtës. “Çdo përpjekje për t’i politizuar vendimet gjyqësore dëmton besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë”, është thënë në reagimin e Gjykatës Supreme. Ndërsa shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Aivo Orav, ka thënë se ndërhyrjet politike në gjyqësor janë të papranueshme, pas reagimit të qeverisë në detyrë për vendimin e Supremes që shfuqizon Udhëzimin Administrativ për pajisjet fiskale dhe softuerët elektronikë fiskalë.

PDK-ja: Mbajtja e pozitës së ministrit dhe deputetit përbën vepër penale, ftojme Prokurorinë ta zbatojë vendimin e Supremes

PRISHTINË, 16 KORRIK - Deputeti i PDK-së, Përparim Gruda, ka thënë se vendimi i Gjykatës Supreme, i bazuar në Ligjin për Qeverinë, ka vulosur faktin se mbajtja e funksioneve të dyfishta nga ana e ministrave që, njëkohësisht, janë edhe deputetë, është e kundërligjshme dhe jokushtetuese.

Gruda në një konferencë për medie ka thënë se pas këtij aktgjykimi, çdo ditë që këta zyrtarë publikë vazhdojnë të mbajnë dy funksione, nënkupton kryerje të veprës penale të moszbatimit të vendimit gjyqësor. “Gjykata Supreme e Republikës së

Kosovës e shpalli të paligjshëm Udhëzimin administrativ nr. 01/2025 për pajisjet elektronike fiskale. Ky vendim u bazua në Ligjin për qeverinë, i cili e ndalon ushtrimin e funksioneve të dyfishta nga ana e ministrave që janë njëkohësisht edhe deputetë. Në këtë rast, ministri i financave, Hekuran Murati, nuk mund të ushtrojë njëkohësisht funksionin e deputetit dhe ministrit. Ky vendim nuk vlen vetëm për një individ, por për të gjithë ministrat dhe për vetë kryeministrin Kurti, të cilët aktualisht janë edhe deputetë në Kuvendin e Kosovës. Gjykata ka vulosur një të vërtetë që ne e kemi theksuar që nga dita

e parë: mbajtja e funksioneve të dyfishta është e kundërligjshme dhe jokushtetuese. Kjo është edhe arsyeja që në seancën e parë e kemi kundërshtuar edhe raportin për verifikimin e mandateve të deputetëve”, ka thënë ai.

PDK-ja i ka bërë thirrje kryeministrit në detyrë, Albin Kurti dhe ministrave që janë njëkohësisht deputetë, që ta respektojnë aktgjykimin e Gjykatës Supreme, duke i liruar menjëherë funksionet ekzekutive për t’ua deleguar ato zëvendësve të tyre, si dhe kërkon që ata t’i ndalin sulmet ndaj gjyqësorit.





SPECIALJA RRËZON MOCIONIN E MBROJTJES NË RASTIN NDAJ LIDERËVE TË UÇK-së

- ‘Historia e Kosovës nuk guxon të shkruhet në sallat e heshtura të gjykatave’

Gjykata Speciale ka rrëzuar mocionin e mbrojtjes së liderëve të UÇK-së në të cilin kërkohej heqja e disa materialeve nga aktakuzat ndaj tyre. Mbrojtja kishte kërkuar të rrëzohen të gjitha akuzat për krimet apo incidentet e kryera para majit të vitit 1998 dhe pas 20 qershorit 1999. Kryetari i trupit gjykues, Charles Smith, duke e arsyetuar vendimin e Speciales, ka sqaruar se incidentet e përmendura nga mbrojtja nuk konsiderohen akuza të veçanta, por pjesë përbërëse e akuzave ekzistuese. Ndaj këtij vendimi të Speciales ka pasur reagime të shumta në Kosovë, duke quajtur këtë vendim zhgënjyes dhe arbitrar. Në këtë kontekst është kërkuar edhe reagimi i shtetit dhe nisja e protestave

EPOKA E RE

Lirim GECI

HAGË, 16 KORRIK - Gjykata Speciale në Hagë ka refuzuar plotësisht mocionin e mbrojtjes që kërkonte heqjen e disa fakteve materiale nga aktakuzave ndaj liderëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi.

Mocioni kishte për qëllim ta sfidonte përfshirjen e ngjarjeve që kanë ndodhur para majit të vitit 1998 dhe pas 20 qershorit 1999. Kryetari i trupit gjykues, Charles Smith, ka sqaruar të

mërkurën se incidentet e përmendura nga mbrojtja nuk konsiderohen akuza të veçanta, por si pjesë përbërëse e akuzave ekzistuese.

Smithi ka thënë se “ajo çfarë kundërshton mbrojtja nuk është një akuzë, por është një pjesë e një akuze në formën e fakteve të materialeve të caktuara” që, sipas tij, përbëjnë akuzat apo pikat në aktakuzë. “Në rastin në fjalë, mbrojtja, në fakt, kundërshton vetëm një prej aspekteve kryesore të paraqitjes provave të ZPS-së dhe ka kërkuar nga trupi gjykues që të rrëzojë atë që e përshkruan si akuza vetëm në lidhje me

pyetjen e dy periudhave kohore që mbrojtja thotë që bie përtej, ose shkon përtej fushëveprimit të konfliktit të armatosur të pretenduar. ZPS-ja vlerëson se në Kosovë ka ekzistuar konflikt jondërkombëtar nga marsi 1998 deri shtator 1999, mbrojtja parashtron se Prokuroria nuk ka vërtetuar që ka pasur konflikt përpara fundit të majit 1998 dhe pas 20 qershorit 1999. Mbrojtja kërkon t’i rrëzojë akuzat në aktakuzë që lidhen për krimet që janë pretenduar të kryhen para fundit të majit 1998 dhe pas 20 qershorit 1999. Incidentet renditen në shtojcën 1”, ka thënë Smith. Sipas

Smithit, rregulla 130 nuk i jep trupit gjykues kompetencën për të rrëzuar pjesë të veçanta të akuzës që përmbajnë fakte materiale, nëse këto nuk përbëjnë akuza të pavarura. Ai ka theksuar se interpretimi i kësaj rregulle kërkon një shqyrtim të plotë të secilës pikë të aktakuzës, e jo të çdo fakti individual që kontribuon në ndërtimin e saj. “Trupi gjykues vëren se incidentet dhe ngjarjet që kanë ndodhur në kohën që kundërshtohen prej mbrojtjes nuk janë akuza brenda kuptimit të Rregullës 130”, ka thënë ai.

Gjyqtari ka thënë se shumë nga faktet në fjalë lidhen me krime kundër njerëzimit, për të cilat, ndryshe nga krimet e luftës, nuk është e domosdoshme të provohet ekzistenca e një konflikti të armatosur. Për këtë arsye edhe nëse argumentet e mbrojtjes do të pranoheshin, ato nuk do të çonin në rrëzimin e ndonjë pike të aktakuzës. “Trupi gjykues nuk është bindur që ka autoritet sipas Rregullës 130 për të rrëzuar pjesë të akuzave ose materiale që formojnë pjesë të aktakuzës, qoftë për arsye kohore apo të

tjera”, ka thënë Smith, duke bërë me dije se mocioni është rrëzuar në tërësinë e vet.

Rregulla 130 në Rregulloren e Procedurës dhe Provave të Dhomave të Specializuara të Kosovës ka të bëjë me mocionet për rrëzimin e akuzave nga aktakuza para fillimit të gjyqimit.

Ky rregull i lejon mbrojtjes të paraqesë kërkesë për të rrëzuar një apo më shumë akuza specifike nëse pretendon se provat e Prokurorisë nuk janë të mjaftueshme për t’i mbështetur ato akuza.

Qëllimi është të mos lejohet që një aktakuzë e pabazuar të kalojë në gjykim të plotë. Ndërkohë, më 15 prill 2025, Zyra e Prokurorit të Specializuar, ka njoftuar se ka përfunduar paraqitjen e provave në këtë rast.

Aktakuza e konfirmuar ndaj Thaçit, Veselit, Krasniqit dhe Selimit është dorëzuar më 30 shtator 2022 dhe përmban dhjetë pika, ku të akuzuarit ngarkohen, kinse për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup

Krasniqi ndodhen në qendrën e paraburgimit në Hagë që nga nëntori i vitit 2020. Ata kanë bërë disa herë kërkesa për lirim me kusht, por nuk janë marrë parasysh nga Gjykata Speciale. Që nga fillimi i procesit gjyqësor janë larguar disa nga avokatët kryesorë për shkak të çështjeve financiare. Për këtë çështje janë kritikuar ashpër institucionet e Kosovës të cilat që nga fillimi i këtij procesi gjyqësor janë duke u drejtuar nga Lëvizja Vetëvendosje.

Reagime të ashpra pas vendimit të Speciales: “Historia nuk guxon të shkruhet në sallat e heshtura të gjykatave”

Rrëzimi i mocionit të avokatëve të liderëve të UÇK-së nga Gjykata Speciale ka ngjallur reagime të ashpra në Kosovë. Lideri i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se historia nuk mund të shkruhet në sallat e heshtura të gjykatave. Ai ka vlerësuar se çlirimtarët e vendit janë të pafajshëm dhe se po presin me padurim vendimin final për lirinë e tyre. “Edhe ky vendim, për fat të keq, përfaqëson një mundësi të humbur për ta forcuar besimin në drejtësinë ndërkombëtare dhe në parimet mbi të cilat ajo duhet të qëndrojë: objektiviteti, paanshmëria dhe e vërteta. Çlirimtarët, familjet e tyre, ne dhe cilido qytetar i Kosovës nuk kemi kërkuar favore, por vetëm drejtësi. Drejtësi që nuk ndikohet nga paragjykimet. Që nuk e ngatërron lirinë me fajin. Sepse liria nuk është faj. Kurrë s'ka qenë. Kurrë s'do të jetë. Historia nuk guxon dhe nuk mund të shkruhet në sallat e heshtura të gjykatave, sepse është shkruar në sakrificat e popullit tonë për liri. Drejtësia mund të vonohet, por e vërteta nuk do të detyrohet asnjëherë. Ata janë të pafajshëm. Ata janë çlirimtarë. Prandaj, e presim me padurim vendimin final për lirinë e tyre. Krenaria dhe dinjiteti i atyre që luftuan për këtë vend mbeten të pathyeshme - përjetësisht! Dielli do të lind përsëri - për çlirimtarët, për Kosovën dhe për të vërtetën”, ka shkruar Krasniqi në “Facebook”. Ndërsa kandidati i PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza, ka thënë se vendimi i trupit gjykues është shumë zhgënjyes. Sipas tij, sjellja dhe vendimet arbitrare të Gjykatës Speciale po e minojnë besimin e popullit në drejtësi dhe do të lënë pasojë të pariparueshme në sistemin juridik. “Shumë zhgënjyes vendimi i sotëm i trupit gjykues në Gjykatën Speciale për mocionin e mbrojtjes së ish-udhëheqësve të UÇK-së. Sjellja dhe vendimet arbitrare të Gjykatës Speciale po e minojnë besimin e popullit tonë në drejtësi dhe do të lënë pasojë të pariparueshme në sistemin juridik. Ne e kemi krijuar Gjykatën Speciale si përgjigje ndaj kërkesës së aleatëve tanë dhe si besim në drejtësinë ndërkombëtare. Nuk e kemi krijuar që bashkësia

ndërkombëtare përmes saj të realizojë agjenda politike jashtë çdo logjike juridike”, ka thënë Hamza, duke shtuar se Kosova nuk do të lejojë që lufta për liri e popullit tonë të komprometohet në emër të një balancimi të rremë të drejtësisë. “Kosova nuk do të lejojë rishkrim të historisë sonë”, ka thënë Hamza. Kurse kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati, ka deklaruar vendimi se është i padrejtë dhe i ngjan një hakmarrje politike. “Ata nuk meritojnë të mbahen pas grilave. Ata meritojnë nderim dhe përkrahje”, ka shkruar Gucati në “Facebook”. Në anën tjetër, ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, Zafir Berisha, ka vlerësuar se mënyra si e ka rrëzuar kjo gjykatë mocionin e avokatëve të Thaçit dhe të tjerëve tregon qëllimin djallëzor të kësaj gjykate. Berisha ka shkruar në “Facebook” se Specialja po ecën drejt realizimit të synimeve të Serbisë. “Mënyra se si Gjykata Speciale rrëzoi mocionin e mbrojtjes së krerëve të UÇK-së është e mjaftueshme për me kuptuar qëllimin djallëzor të kësaj gjykate. Kjo gjykatë me hapa të sigurt po ecën drejt realizimit të synimeve të Serbisë, argatëve të saj në Kosovë dhe atyre që e sponzorizuan këtë gjykatë. Kam pritur si qytetar i Kosovës nga Shqipëria për të dhënë kontributin e saj në mekanizmat ndërkombëtar për ta demantuar skenarin dhe skenaristët e themelimin të kësaj gjykate, mirëpo po shihet se edhe atje ka pasur fjalë koti dhe retorikë boshe patriotike”, ka shkruar ai. Sipas tij, dënimi eventual i krerëve të UÇK-së është pikënisje e zhbërjes së shtetit të Kosovës. “Dënimi eventual i Hashimit me shokë, është pikënisja e zhbërjes së shtetit të Kosovës, për të cilën po angazhohet Serbia dhe

qeveria kuislinge e Albinit”, ka shkruar Berisha. E deputetja e PDK-së, Ganimete Musliu, ka kërkuar protesta të pandalshme popullore në Kosovë dhe Bruksel. Ajo ka thënë se Gjykata Speciale ka pasur si objektiv vazhdimin e proceseve të UNMIK-ut dhe EULEX-it për përndjekjen e ushtarëve të UÇK-së, duke akuzuar qeverinë aktuale të Kosovës për pasivitet dhe dështim në mbrojtjen e interesave të vendit. Ndaj vendimit të Speciales ka reaguar edhe kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, deputetja e PDK-së, Vlora Çitaku, etj.

Shoqatat e dala nga lufta: Zhgënjyes dhe i padrejtë vendimi i Speciales, s’mund të mbyllen sytë para realitet që njih bota

Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së (OVLUÇK), Shoqata e Invalidëve të Luftës (ShIL) dhe Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve (ShFD) kanë reaguar ndaj rrëzimit të mocionit të mbrojtjes së krerëve të UÇK-së nga Dhomat e Specializuara, duke e cilësuar vendimin zhgënjyes dhe shqetësues për drejtësinë. “Kur përballë fakteve, dëshmime dhe shkeljeve procedurale mohohet edhe një shqyrtim i drejtë i mocioneve mbrojtëse, krijohet përshtypja e një procesi të njëanshëm dhe të orientuar politikisht. Qëndresa jonë nuk do të ndalet. UÇK-ja dhe drejtuesit e saj nuk kanë nevojë për mëshirë, por për një gjykim të drejtë, të barabartë dhe të bazuar në të vërtetën historike të luftës për liri. Gjykata nuk mund të mbyllë sytë para realitetit që e njih bota se UÇK-ja ishte forcë çlirimtare. I bëjmë thirrje opinionit publik dhe komunitetit ndërkombëtar që

të mos bien pre e një narrative të shtrembëruar. Kjo gjykatë po rrezikon të shndërrohet në mjet për rishkrim të historisë, e jo në garanci të drejtësisë. Në emër të të gjithë atyre që sakrifikuan për lirinë e Kosovës, do të qëndrojmë gjithmonë në mbrojtje të së vërtetës dhe të drejtave të bashkëluftëtarëve tanë”, është thënë në reagimin e këtyre organizatave.

LV-ja flet më në fund për padrejtësitë e Gjykatës Speciale, por godet Thaçin dhe deputetët që e votuan

Lëvizja Vetëvendosje ka reaguar ndaj rrëzimit të mocionit të mbrojtjes së krerëve të UÇK-së nga Dhomat e Specializuara, duke e cilësuar vendimin zhgënjyes dhe shqetësues për drejtësinë. Vetëvendosja që drejtohet nga Albin Kurti ka thënë se vendimi për rrëzimin e mocionit të mbrojtjes nga Gjykata Speciale është dëshmi e një logjike të përmbysur të drejtësisë, ku vija ndarëse midis çlirimit dhe agresionit zbehet qëllimshëm. “Pas pak ditësh bëhen 10 vjet nga themelimi me ndryshime kushtetuese dhe ligje të veçanta të Gjykatës Speciale. Katër nga drejtuesit e Ushtrisë Çlirimtare Jakup Krasniqi, Hashim Thaçi, Rexhep Selimi dhe Kadri Veseli kanë afër 5 vite në paraburgim. Vendimi i sotëm për rrëzimin e mocionit të mbrojtjes nga Gjykata Speciale është dëshmi e një logjike të përmbysur të drejtësisë, ku vija ndarëse midis çlirimit dhe agresionit zbehet qëllimshëm, ndërsa përpjekja e një populli për liri vihet nën dyshim me mjete juridike. Ky model i drejtësisë selektive nuk bën drejtësi universale, por prodhon një narrativë të rreme, që e

zhvendos fajësinë nga pushtuesi tek i çliruari”, është thënë në reagimin e LV-së, duke shtuar se Gjykata Speciale, e themeluar përtej çdo praktike të zakonshme ndërkombëtare, ka vepruar si instrument i imponuar mbi sovranitetin e Kosovës. “Në vend që t'i shërbejë të drejtës, ajo i ka shërbyer paragjykimit. Madje duke hetuar dhe gjykuar padrejtësisht vetëm një palë, ajo ka përjashtuar sistematikisht dhunën shtetërore serbe që është burimi real i gjenocidit dhe krimeve të luftës e krimeve kundër njerëzimit të kryera në Kosovë. Më 29 prill dhe 15 maj 2023 Enver Dugolli si i mbijetuar i masakrës në Burgun e Dubravës i është drejtuar Prokurorit të Prokurorisë Speciale në Hagë me kërkesën për nisjen e hetimeve të krimeve të kryera gjatë planifikimit dhe ekzekutimit të masakrës së Burgut të Dubravës. Ndonëse Prokurori ka kthyer përgjigje se kërkesa do të shqyrtohet ende sot nuk ka asnjë veprim të njoftuar në këtë drejtim”, është thënë në këtë reagim, duke fajësuar deputetët që kanë votuar pro themelimit të Speciales. “Ata qeveritarë e deputetë që e miratuan e votuan e ata gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese që e konfirmuan këtë gjykatë në vitin 2015 bartin përgjegjësi të drejtpërdrejtë. Ata duhet sot të kërkojnë falje, jo si akt formal, por si shenjë vetëdijeje për dëmin e madh institucional dhe moral që kjo gjykatë i ka shkaktuar vendit, kujtesës sonë kolektive dhe të ardhmes tonë. Ky do të ishte hapi i parë me të cilin duhet nisur një përbashkim për t'u mbrojtur jo vetëm juridikisht por edhe shoqërisht nga rreziku i shtrembërimit të thelbit të luftës sonë”, është thënë në reagimin e Vetëvendosjes.



HARADINAJ IA MERR LIMAJT ISH-DEPUTETIN, ENVER HOTI NOMINOHET KANDIDAT I AAK-së PËR KRYETAR TË MALISHEVËS

PRISHTINË, 16 KORRIK - Lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka paraqitur të mërkurën përforcimin më të ri të AAK-së. Ai ka bërë me dije se ish-deputeti i Nismës, Enver Maloku, i është bashkuar AAK-së.

Haradinaj ka shkruar në "Facebook" se Hoti do të jetë edhe kandidat i AAK-së për kryetar të komunës së Malishevës. "Mirë se vjen në Aleancë, Enver Hoti! I njohur për përkushtimin ndaj vendit dhe vlerat e tij atdhetare, Enver Hoti i përket brezit të veprimtarëve të hershëm të angazhuar në çështjet kombëtare. Me një përvojë të pasur institucionale, ai ka shërbyer me profesionalizëm

e integritet në çdo përgjegjësi që ka bartur. Aderimi i tij në Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës është një vlerë e shtuar për vizionin tonë politik dhe përkushtimin ndaj qytetarëve", ka shkruar Haradinaj, duke shtuar se përvoja e Hotit do t'i shërbejë për mirë AAK-së.

"Enver Hoti, gjithashtu, do të jetë kandidati ynë për kryetar të komunës së Malishevës. Me përvojën, vendosmërinë dhe besimin në vlerat e Aleancës, ai përfaqëson më së miri frymën tonë, për një qeverisje të drejtë dhe transparente. Urime Enver! Paçim sukses dhe fitore të përbashkët në shërbim të Malishevës dhe qytetarëve të saj!", ka shkruar Haradinaj.



KOMANDANTI I FSK-së NË WIESBADEN TË GJERMANISË ME FTESË TË USHTRISË AMERIKANE



PRISHTINË, 16 KORRIK - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralletënant Bashkim Jashari, ka udhëtuar për Wiesbaden të Gjermanisë me ftesë të shefit të Shtabit të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës,

gjeneral Randy Alan George, për të marrë pjesë në Konferencën e Ushtrive Evropiane (CEA). Në këtë konferencë kanë marrë pjesë shefat e mbrojtjes nga më shumë se 40 vende, ka njoftuar FSK-ja. "Në kuadër të

konferencës, tema kryesore ishte 'Ndërtimi i Gatishmërisë për Parandalimin Global', ku është theksuar rëndësia e të menduarit strategjik dhe bashkëpunimit ndërkombëtar për të tejkaluar sfidat globale të sigurisë. Gjatë konferencës po

ashtu janë zhvilluar diskutime të rëndësishme për gatishmëri dhe përmirësim kolektiv, rritjen e ndërveprueshmërisë dhe gjithashtu shfrytëzimin e të dhënave të drejtpërdrejta për analizimin e strategjive ushtarake", ka njoftuar FSK-ja.

Pjesëmarrja në këtë konferencë të nivelit të lartë, sipas FSK-së, është dëshmi e angazhimit të Kosovës në arkitekturën e sigurisë ndërkombëtare dhe rolit të saj si partnere e besueshme në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Arrestohen katër persona pas bastisjeve në Agjencinë Kadastrale dhe atë të Arkivave

PRISHTINË, 16 KORRIK - Policia e Kosovës në koordinim me Prokurorinë Themelore të Prishtinës ka përfunduar bastisjen në Agjencinë Shtetërore të e Arkivave dhe në atë Kadastrale nën dyshimet për keqpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar. Pas përfundimit të këtij aksioni

janë arrestuar katër persona. "Prokuroria Themelore në Prishtinë, në koordinim dhe bashkëpunim të ngushtë me Policinë e Kosovës, sipas urdhërës nga gjykata, ka marrë aksion për bastisje dhe kontroll në institucionin e Arkivit Shtetëror dhe institucionin Kadastral të Republikës së

Kosovës për veprën penale 'Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar' nga neni 414 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Prokurori i shtetit për çdo zhvillim të mëtejshëm do t'ju mbajë të informuar", është thënë në përgjigjen e zyrtares nga Prokuroria Themelore e Prishtinës, Kaltrina Shala.



Nënshkruhet marrëveshja për mbrojtjen e të dhënave personale

Prishtinë, 16 korrik - Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP), Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Policia e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) dhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK), kanë nënshkruar të mërkurën marrëveshjen për bashkëpunim ndërinstucional për mbrojtjen e të dhënave personale në kontekstin e komunikimit publik.

Në njoftimin e AIP-it është thënë se në kuadër të marrëveshjes institucionet do të angazhohen për parandalimin e publikimeve

të paautorizuara të të dhënave personale në medie dhe publik, ndërmarrjen e veprimeve për forcimin e rregullatave të akteve nënligjore të institucioneve për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe rritjen e kapaciteteve profesionale për zyrtarët e institucioneve dhe medieve. “Marrëveshja ka për qëllim të adresojë shqetësimet për shpërndarjen apo publikimin e të dhënave personale në media dhe palë të treta, përveç në rastet kur një veprim i tillë është i bazuar në dispozitë të qartë ligjore apo

autorizim të posaçëm nga organi kompetent gjyqësor”, ka njoftuar AIP-i.

Në zbatimin e detyrimeve ligjore, në kuadër të zbatimit të marrëveshjes, institucionet do të themelojnë Grupin Koordinues të përbashkët i cili do ta monitorojë zbatimin e marrëveshjes dhe do të ndërmarrë veprime për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të institucioneve për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve të Republikës së Kosovës.



ÇITAKU: KOMENTET PËR DEKLARATAT E ZYRTARËVE AMERIKANË DUHET TË BËHEN ME SHUMË KUJDES

PRISHTINË, 16 KORRIK - Ish-ambasadorja e Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe deputetja e PDK-së, Vlora Çitaku, duke komentuar deklaratat e presidentes Vjosa Osmani dhe reagimin ndaj saj të zyrtarit amerikan, Richard Grenell, ka thënë se zyrtarët e Kosovës duhet të përmbahen nga komentimi publik i deklaratave të zyrtarëve të lartë amerikanë.

Çitaku në intervistë për “Ekonomia Online” ka thënë se çfarëdo lloj pikëpyetjeje duhet të ngrihet në takim të mbyllur. “Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës, po edhe ne si zyrtarë të zgjedhur, si deputetë të zgjedhur, si përfaqësues politikë, duhet të jemi shumë të kujdesshëm dhe shumë të vëmendshëm në komunikimin tonë publik dhe të përmbahemi nga komentimi i deklaratave të zyrtarëve të lartë të ShBA-së. Çfarëdo lloj pikëpyetjeje, çfarëdo lloj dileme duhet të ngrihet në diskrecion, në takim të mbyllur, sepse vetëm kështu mund ta ruajmë dhe mund ta kursejmë njëri-tjetrin”, ka thënë Çitaku.

Ajo ka vlerësuar trashëgiminë e ish-presidentit amerikan Donald Trump si shumë pozitive për Ballkanin Perëndimor, duke përmendur, përveç marrëveshjes së Uashingtonit, edhe anëtarësimin e Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut në NATO. Megjithatë, Çitaku ka thënë se komentet për deklaratat e zyrtarëve amerikanë duhet të



bëhen me shumë kujdes. “Duhet thënë që trashëgimia e presidentit Trump gjatë administratës së tij të parë në Ballkanin Perëndimor është jashtëzakonisht pozitive përtej Marrëveshjes së Uashingtonit të dakorduar mes Kosovës dhe Serbisë. Kemi pasur edhe anëtarësimin e Malit të Zi në NATO, anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO, një varg iniciativash të cilat kanë sjellë më shumë stabilitet në

Evropën Juglindore në përgjithësi dhe në Ballkanin Perëndimor në veçanti. Mirëpo, ne duhet të jemi jashtëzakonisht të matur kur synojmë që të komentojmë apo të sqarojmë deklaratat të zyrtarëve të kartës së ShBA-së. Ky është një luks që jo vetëm Kosova, por edhe shtete shumë më të mëdha dhe më të fuqishme se ne nuk e kanë. Çfarëdo lloj dileme, paqartësie duhet të trajtohet në kanale diplomatike dhe në diskrecion të plotë”, ka shtuar ajo.

Çitaku përmend mungesën e vizitave zyrtare të nivelit të lartë të Kosovës në Shtëpinë e Bardhë si tregues i qasjes së dobët të kësaj qeverie në raport me aleatët strategjikë të Kosovës. “Unë kam shërbyer në ShBA-ja për shtatë vjet dhe nuk ka ndodhur asnjëherë që të kalojë vit pa ndonjë vizitë të nivelit të lartë në Shtëpinë e Bardhë. Tash kanë kaluar më shumë se pesë vjet dhe nuk kemi pasur asnjë zyrtar të lartë të institucioneve të Kosovës

në Zyrën Ovale dhe në Shtëpinë e Bardhë, as gjatë kohës së presidentit Biden, i cili ka qenë një mik i përkushtuar i Kosovës dhe Ballkanit Perëndimor, e as në kohën e administratës së re të Trumpit, që na lë të nënkuptojmë që problemi nuk është në Uashington, por problemi është te qasja joprofesionale dhe aventuriere, me të cilën Kurti dhe kjo kastë qeverisëse i është qasur aleancave më strategjike të Kosovës”, ka thënë Çitaku.

Osmani: Kosova është dhe mbetet një aleate e besueshme në mbrojtje të vlerave demokratike

RIGA, 16 KORRIK - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka ndarë momente nga vizita e saj në Letoni. Ajo në Riga ka vizituar Qendrën e Ekselencës së NATO-s për Komunikim Strategjik (STRATCOM), një institucion kyç në luftën kundër kërcënimeve hibride dhe në mbrojtje të integritetit të informacionit. “Diskutuam për thellimin e bashkëpunimit në ndërtimin e kapaciteteve në siguri kibernetike dhe komunikim

strategjik si pjesë e përpjekjeve të Kosovës për anëtarësim në NATO”, ka thënë Osmani. Më tutje, Osmani ka theksuar se ka pasur edhe një diskutim në Shtëpinë e Evropës bashkë me gra lidere dhe aktiviste në Letoni për të ndarë me to rrugëtimin e Kosovës si vend që ka përjetuar luftën, por që sot avancon përpara me gratë në qendër të çdo procesi demokratik dhe të sigurisë. “Vizitën e përmbyllëm në

Muzeun e Okupimit të Letonisë si një moment reflektimi të thellë mbi historinë e përbashkët të qendresës ndaj pushtimit dhe padrejtësisë. Si Kosova ashtu edhe Letonia mbijetuan përmes rezistencës dhe krenarisë kombëtare. Kujtesa kolektive është forca jonë, për të mos harruar të kaluarën e lavdishme dhe për të ndërtuar një të ardhme të drejtë e të sigurt”, është shprehur Osmani.



Parandalohet kontrabanda me cigare në aeroportin 'Adem Jashari'

Prishtinë, 16 korrik - Policia e Kosovës ka bërë me dije se në bashkëpunim me Doganën e Kosovës ka parandaluar tentimet për kontrabandë me cigare në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari". Në njoftimin e policisë është

thënë se në dy raste të ndara janë ndaluar dy shtetas të huaj në tentativë për t'i larguar nga Kosova rreth 375 boksa cigare të llojeve të ndryshme, të padeklaruar dhe pa banderola. "Pasagjerët kishin fshehur cigaret në valixhe dhe i kishin dorëzuar në check-in për

fluturim drejt Londrës. Sasitë e sekuestruara përfshijnë 'Malboro' të kaltër, të bardhë, të kuqe, si dhe marka tjera të njohura. Në të dy rastet, mallrat janë zbuluar në bashkëpunim edhe me Njësitin e Informacionit të Pasagjereve (PIU). Të gjitha produktet janë

sekuestruar dhe rastet janë proceduar për hetim të mëtejshëm nga Dogana e Kosovës. Policia dhe Dogana e Kosovës mbeten të përkushtuara në luftimin e kontrabandës dhe mbrojtjen e ligjshmërisë në vend", ka njoftuar policia.



KOSOVARËT 'PUSHTOJNË' SHQIPËRINË: MBI 300 MIJË QYTETARË KALUAN NGA MORINA PËR PUSHIME GJATË DY JAVËVE TË FUNDIT



PRISHTINË, 16 KORRIK - Sezoni turistik në Shqipëri ka hyrë në pikun e tij, ndërsa në pikat kufitare me Kosovën po vihet re një rritje e madhe e hyrjeve. Në Doganën e Morinës fluksi i automjeteve dhe autobusëve me pushues nga Kosova është i lartë jo vetëm gjatë fundjavave, por edhe në ditët e zakonshme të javës. Pushuesit nga Kosova kanë thënë se këtë vit ka më pak probleme në bregdetin shqiptar. Sipas tyre, çmimet

janë më të arsyeshme dhe plazhet publike më të pastra dhe më të rregulluara. Fluksi i madh ka edhe në Doganën e Kosovës në Vërmicës ku, përveç turistëve, kalojnë edhe shumë emigrantët nga Kosova që kthehen për pushime në vendlindje. Shumë prej tyre zgjedhin të kalojnë disa ditë edhe në bregdetin shqiptar, por kanë theksuar se mikpritja dhe shërbimet duhet të përmirësohen më tej.

Autoritetet doganore në Morinë dhe Vërmicë janë duke punuar me nga 6 sportele në hyrje dhe dalje për t'i shmangur pritjet e gjata. Shtetasit e Shqipërisë dhe Kosovës kalojnë pa kontroll, ndërsa për të huajt janë vendosur procedura të përsheptuara, njofton "A2CNN". Në mesditë vihet re edhe një fluksi i lartë i kamionëve që transportojnë mallra në të dy drejtimet, duke treguar për

rritjen e aktivitetit tregtar në këtë periudhë të verës. Sipas informacioneve dogana në Morinë, nga 1 korriku deri më 15 korrik janë përpunuar në hyrje të Shqipërisë, 328 mijë e 143 shtetas dhe 98 mijë e 347 mjete dhe në dalje të 367 mijë e 235 shtetas dhe 122 mijë e 471 mjete. Numri i lartë i hyrjeve nga Shqipëria në Kosovë lidhet me disa faktorë. Një pjesë e madhe përbëhet nga emigrantët kosovarë që

kthehen në vendlindje për pushime. Një tjetër pjesë janë turistët e huaj, të cilët gjatë qëndrimit të tyre disaditorë në Shqipëri, zgjedhin të vizitojnë edhe Kosovën. Si emigrantët kosovarë, ashtu edhe turistët e huaj, përdorin Rrugën e Kombit si korridor tranziti për të hyrë në Kosovë. Ndërsa shifra e hyrjeve në Shqipëri është vetëm e qytetarëve të Kosovës pa përfshirë ato edhe të vendeve të rajonit.

Hoti: Importet nga Serbia janë rritur për mbi 200 për qind në janar-maj 2025 krahasuar më 2024

PRISHTINË, 16 KORRIK - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka bërë me dije se importi i mallrave nga Serbia është rritur për mbi 200 për qind në janar-maj të vitit 2025 krahasuar me këtë periudhë të vitit 2024. Hoti ka shkruar në

"Facebook" se importet janë rritur në 91.31 milionë euro për këta muaj. "Në periudhën janar-maj 2025, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024, importi i mallrave në Kosovë nga Serbia është rritur me 217 për qind. Nga 42.08 milionë euro të importuara gjatë muajve

janar-maj 2024, importet janë rritur në 91.37 milionë euro për muajt janar-maj 2025. Duke pasur parasysh natyrën e mallrave që importohen nga Serbia, ka shumë gjasa që prodhimi vendor të jetë zvogëluar për shumën e rritur të importit nga Serbia", ka shkruar Hoti.



UKRAINA, RUSIA DHE GJËZA E MADHE NË MENDJEN E DONALD TRUMPIT



Në ditën pasi Donald Trumpi bëri shpalljen e madhe për shitjen e armëve europianëve me destinacion Kievin dhe ultimatumit ndaj Putinit, nuk mungojnë dyshimet dhe pasiguritë, veçanërisht përse i përket të ardhmes afat gjatë. Evropa është e kënaqur me këtë kthesë në çështjen e armëve, megjithëse nuk beson në efektivitetin e kërcënimit me “taksa dhe sanksione” brenda 50 ditësh.

Gjithashtu, edhe sekretari i NATO-s, Mark Rutte, duke folur në Zyrën Ovale pranë Trump-it, e ka quajtur “të vetëkuptueshëm” faktin që presidenti amerikan kërkon që për armët të paguajnë vetë europianët.

Armët

Një tjetër temë është cilat armë do të dërgohen. Prej ditësh qarkullojnë zëra për mundësinë që të dërgohen edhe raketa me rreze të gjatë veprimi, por as Trump dhe as Rutte nuk dhanë detaje të qarta të hënën mbi përmbajtjen e “pakos”, përveç sistemit mbrojtës Patriot. Burime anonime të cituara nga gazetatat amerikane pohojnë se Trump ka dërguar edhe armë ofensive, konkretisht raketat Atacms (Army Tactical Missile System), me autorizimin për të goditur objektiva brenda territorit rus deri në 300 km largësi (pa arritur qytete si Moska apo Shën Petersburgu, por që mund të godasin baza dhe depo armësh në thellësi). Gjithashtu, Ukraina ka kërkuar – por nuk ka marrë ende – raketat Joint Air-to-Surface Standoff Missiles (JASSM), të cilat kanë rreze më të madhe se Atacms dhe mund të lëshohen nga avionët F-16 (tashmë të dhuruar nga vendet evropiane për Kievin). Dje, presidenti amerikan deklaroi

se për momentin nuk ka ndërmend të dërgojë raketa me rreze të gjatë, por pa e përjashtuar këtë në të ardhmen. Megjithatë, ai vetë kishte ngjallur shpresa te Zelensky, duke e pyetur më 4 korrik nëse Ukraina ishte në gjendje të godiste Moskën dhe Shën Petersburgun. Tani, Shtëpia e Bardhë thotë se ishte thjesht një pyetje. I dërguari i Trump në NATO, Matt Whitaker, thotë se prioritet janë sistemet mbrojtëse – raketat Patriot, që mund të pengojnë raketat balistike ruse – dhe që pritet të mbërrijnë këto ditë nga rezervat evropiane, ndërkohë që europianët presin t’u dërgohen të reja nga SHBA. Vetë ukrainasit i konsiderojnë Patriotët një çështje urgjente: kanë tetë të tilla, prej të cilave shumë nuk funksionojnë dhe shumë zona nuk janë të mbrojtura nga sulmet ajrore ruse. Por të gjithë ekspertët theksojnë se, përveç raketave Patriot, janë të domosdoshme armë sulmuese që t’u mundësojnë ukrainasve të marrin iniciativën në fushën e betejës. “Më shumë armë ofensive për të

goditur objektiva përtej vijës së frontit,” – thuhej në një editorial të Washington Post – “është treguar shumë ndrojtje, nga frika e përshkallëzimit të konfliktit me një fuqi bërthamore.”

Sanksionet

Pikërisht pasi kërcënoi me sanksione sekondare ndaj vendeve që blejnë gaz dhe naftë ruse, Trump i kërkoi senatorëve republikanë të pezullojnë përkohësisht një projektligj që parashikon sanksione sekondare me 500%. Kjo nismë kishte mbështetjen e 85 senatorëve republikanë, por lideri i republikanëve në Senat, John Thune, deklaroi se “për momentin, presidenti dëshiron ta menaxhojë vetë këtë çështje.” A është vërtet Trump i gatshëm të ecë përpara me sanksione sekondare që do të goditnin Kinën dhe Indinë, rivalët dhe partnerët kryesorë të SHBA-së? Edhe vetë SHBA do të ndëshkohej, për shkak të rritjes së çmimit të naftës. Shumë nuk besojnë se Trump do të ishte i

gatshëm të sakrifikoje këto marrëdhënie për Ukrainën. Ndërkohë, me të dy vendet (Kinën dhe Indinë) po zhvillohen negociatat për tarifën. Sipas politologut Ian Bremmer, Trump po e kupton se ndodhet në një pozicion më të dobët sesa mendonte, si politikisht (në aspektin e durimit) ashtu edhe ekonomikisht (për shkak të varësisë nga Kina për mineralet e rralla). Për të fituar një luftë tregtare me Kinën, administrata e tij ka sugjeruar heqjen e kufizimeve për eksportin e mikroçipave, në një përpjekje për të zbutur tensionet në afat të shkurtër. A do të mundnin New Delhi dhe Pekini të reduktonin varësinë nga Rusia brenda këtyre 50 ditëve? E pamundur, duke pasur parasysh kompleksitetin e një operacioni të tillë. Por Kina mund të ushtrojë presion mbi Moskën për të mos e shtyrë luftën drejt përshkallëzimit. Nuk është e thënë që kinezët ta duan këtë: rrezikojnë që vëmendja amerikane të zhvendoset nga Rusia në Indo-Paqësor. / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Drejtori i Leverkusenit: Ka interesim për Xhakën

LEVERKUSEN, 16 KORRIK - Drejtori sportiv i Bayer Leverkusenit, Simon Rolfes, ka komentuar situatën e mesfushorit shqiptar Granit Xhaka i cili ka qenë shumë i lidhur me një largim gjatë kësaj vere. Klubi saudit Neom SC është i etur të nënshkruajë me

mesfushorin e Leverkusenit, Granit Xhaka. Ata i kanë ofruar shqiptarit 32-vjeçar një pagë tërheqëse. Vërehet se Leverkuseni e vlerëson mesfushorin me 20 milionë euro dhe Neom ka të ngjarë të jetë në gjendje ta financojë marrëveshjen.

Drejtori sportiv i klubi gjerman, Simon Rolfes, ka komentuar situatën e djaloshit me prejardhje nga Kosova. “Ka interesim, por ende asgjë konkrete. Aktualisht po finalizojmë skuadrën, e cila duhet të jetë rreth 95 % e plotë në këtë fazë të përgatitjeve. Graniti

është një pjesë e rëndësishme e këtij procesi. Kjo është arsyeja pse vendimi do të merret shumë shpejt”, ka thënë Rolfes. Për më tepër, në sezonin 2024/25 Xhaka luajti 49 ndeshje për Leverkusenin në të gjitha garat, duke shënuar 2 gola dhe duke dhënë 7 asistime.



DRITA KRENOHET ME SUKSESIN HISTORIK, RAMADANI ‘KËRCËNON’ EDHE COPENHAGENIN

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 16 KORRIK - Kampionia e Kosovës, Drita, ka shkruar histori, duke u bërë skuadra e parë e Kosovës që kalon në raundin e dytë kualifikues të Ligës së Kampioneve. Skuadra nga Gjilani mposhti Differdange me rezultat 3-2 në udhëtim, pasi më parë kishte fituar edhe ndeshjen e parë në shtëpi me rezultat 1-0 në kuadër të raundit të parë kualifikues të garës më prestigjioze evropiane për klube. Pas këtij suksesi historik, klubi gjilanas ka reaguar me entuziazëm përmes një postimi në rrjetet sociale, ku e cilësoi këtë arritje si një moment të paharrueshëm që “u shkrua me shkronja të arta”, ndërsa falënderoi tifozët për mbështetjen e tyre të zjarrtë. “Në një mbrëmje të paharrueshme në Differdange, kur historia u shkrua me shkronja të arta, nuk ishin vetëm 11 lojtarë në fushë -



ishit edhe JU, tifozët tanë të zjarrtë, që udhëtuat nga çdo cep i Evropës për të qenë pranë nesh! Entuziazmi dhe dashuria që sollët në stadium na dhanë forcën për ta bërë realitet këtë ëndërr - kalimin në raundin e dytë të Ligës së Kampioneve! Faleminderit për çdo kilometër

të përshkuar, për çdo britmë për Dritën, për çdo emocion të ndarë me ne. Ky sukses është edhe i juaj! FORCA Drita – për qytetin, për klubin, për Kosovën!”, thuhet në reagimin e klubit. Në anën tjetër pas këtij suksesi ka folur edhe trajneri Zekirija

Ramadani, i cili ka theksuar se ky sukses nuk është rastësor, por rezultat i punës së palodhshme dhe i besimit në cilësinë e skuadrës. “Kam besuar në punën që kemi bërë dhe në cilësinë e ekipit – dhe ja që u kualifikuam në raundin e dytë. Në këtë kanë besuar të gjithë në

skuadrën tonë, dhe së bashku arritëm ta kalojmë raundin e parë. Ishte një obligim profesional dhe kolektiv ta përmbushnim këtë sfidë dhe ia dolëm”, ka thënë Ramadani. Sa i përket kundërshtarit të radhës, gjigantit danez Copenhagen, Ramadani e pranoi se bëhet fjalë për një ekip shumë të fortë, por tha se nëse Drita dëshiron të jetë lajm në Evropë, atëherë duhet të përballët dhe të eliminojë klube të këtij niveli. “Tani kemi përballë një kundërshtar ndryshe. Do të bëjmë analizën dhe më pas, si staf, do ta përgatitim skuadrën në mënyrën më të mirë të mundshme. Futbollistët tanë e dinë se çfarë kërkohet prej tyre dhe kanë kapacitetin ta japin maksimumin në fushë. Me flamur të bardhë nuk do të dalim! Nëse duam të bëhemi lajm kryesor në Evropë duhet të eliminojmë kundërshtarë të këtij rangui”, ka deklaruar Ramadani.

BASHKIMI PËRFORCOHET ME QENDRËN DE’QUON LAKE, HAXHOSAJ RIKTHEHET TE PRISHTINA

PRIZREN, 16 KORRIK - KB Bashkimi është përforcuar me qendrën De’Quon Lake. Prizrenasit besojnë se përvoja ndërkombëtare e basketbollistit të gjatë 208 centimetra do t’i ndihmojë ata në sezonin 2025/26. “Me shumë kënaqësi prezantojmë qendrën De’Quon Lake (208 cm) si përforcimin më të ri për sezonin 2025/26! Lake ka përvojë të pasur ndërkombëtare. Karrierën e nisi

në Hungari me Falco Szombathely, ku fitoi Kupën dhe Kampionatin, duke u aktivizuar edhe në Basketball Champions League. Më pas ka luajtur për Tsmoki-Minsk, Oklahoma City Blue (G-League), Humacao, Czarni Slupsk, SZTE Szeged dhe së fundmi Atomeromu Paks. Në sezonin e fundit 2024/25 me Paks, shënoi mesatarisht 9.2 pikë dhe 7.1 kërcime për

ndeshje, me 69.1 % saktësi në gjuajtje. Ai sjell fuqinë fizike, eksperiencën dhe prezencën e fortë në zonën e trapezit, armë të vlefshme për sfidat që na presin! Mirë se erdhe në Prizren, De’Quon!”, ka njoftuar skuadra e Bashkimit. Ndërsa KB Prishtina ka bërë me dije transferimin e dytë zyrtar për këtë verë, duke rikthyer në skuadër basketbollistin Dion Haxhosaj. Haxhosaj vjen nga



skuadra e Borës, ku ka kaluar vitet e fundit, ndërsa rikthimi te bardhekaltrit përfaqëson një hap të njohur për të, pasi ai ka qenë pjesë e Prishtinës edhe më parë. Ky është përforcimi i dytë i konfirmuar nga Prishtina në këtë afat kalimtar pas Arian Azemit në kuadër të përgatitjeve për sezonin e ri, ku synimet janë rikthimi në majat e basketbollit vendor.

Stërvitje e përbashkët në kampin përgatitor në Slloveni

PEJË, 16 KORRIK - Klubi i Xhudos “Z’dezele” Sankaku në Celje, Slloveni, ka mirëpritur xhudistë e xhudiste nga Kosova, Japonia, Suedia, Republika Çeke, Kroacia dhe vendaset e saj për

kampin përgatitor që po zhvillohet atje. Në këtë kamp po marrin pjesë edhe xhudistët dhe xhudistet nga Kosova, Distria Krasniqi, Laura Fazliu, Dëbora Gjakova, Fatjona

Kasapi, Flaka Loxha, Sidorela Dodaj, Enise Zijade, Fiona Kuka, Riadi Kasapi, Roni Reshitaj, Miloti Gashi dhe Jon Kuka. “Ata po punojnë me përkushtim nën udhëheqjen e trajnerëve, Driton

Kuka, Majlinda Kelmendi dhe Fatos Tabaku, duke zhvilluar formën e tyre fizike dhe teknike për garat e radhës”, thuhet në njoftimin e Federatës së Xhudos së Kosovës.



Modriçi: E zgjedha Milanin sepse doja të qëndroja në Evropë

MILANO, 16 KORRIK - Ish-mesfushori i Real Madridit, Luka Modriç, ka folur hapur për vendimin e tij për t'iu bashkuar AC Milanit pas përfundimit të aventurës së gjatë në "Santiago Bernabeu". Shumë klube donin transferimin e veteranit kroat,

por ai ka zbuluar se Milanit iu bashkua pasi donte të luante në Evropë dhe të luante futboll konkurrues. "Pse AC Milan? Doja të qëndroja në Evropë dhe të vazhdoja të luaja futboll konkurrues", ka thënë Modriçi. "Kisha disa oferta të tjera, por kur Milani

u shfaq, ishte e qartë për mua. Isha gati që nga momenti i parë", ka shtuar Modriçi. Ai tregoi se klubi kuqezi e kishte bindur që në fillim me seriozitetin e qasjes dhe me projektin e tyre. "Më bëri përshtypje se si erdhën në Kroaci për të ma prezantuar

projektin dhe gjithçka tjetër. Kjo ishte shumë e rëndësishme për mua. Milani është një nga klubet më të mëdha në Evropë", ka përfunduar mesfushor kroat i cili pritet të jetë një nga liderët e rinj të skuadrës së Massimiliano Allegrit.



Përfundon afati i rregullt kalimtar i verës në hendboll

PRISHTINË, 16 KORRIK - Ka përfunduar afati i rregullt kalimtar i verës në hendbollin e Kosovës. Disa lojtarë kanë vendosur për skuadrat e reja e shumë të tjerë kanë kërkuar status të lirë dhe kështu të fitojnë të drejtën që ndërkohë të vendosin për klubin e ri. Te hendbollistët më së shumti kërkesa ka bërë Vëllaznimi i Gjakovës, që kthehet në Superligë. Kjo skuadër ka paraqitur kërkesë për të kthyer ish-lojtarë të saj që ishin te Trepça, Rahoveci e Prishtina. Te hendbollistët janë nëntë kërkesa gjithsej, ndërsa te hendbollistët nëntë. Ndërkohë janë plot 23 kërkesa për status të lirë të lojtarëve. Për të gjitha kërkesat do të vendosë Komisioni për Regjistrim. Lojtarët mund të ndryshojnë mjedis deri më 15 tetor, pos lojtarëve me status të lirë mund të lëvizin edhe lojtarët me fletëlëshim të klubit.

Konkurrenca e meshkujve:

Arber Neziri (KH Trepça-KH Vëllaznimi), Florian Rexha (KH Rahoveci-KH Vëllaznimi), Ardi Halili (KH Trepça-KH Vëllaznimi), Erris Brahushi (KH Trepça-KH Vëllaznimi), Luigj Kolaj (KH Trepça-KH Vëllaznimi),



Menot Pozhegu (KH Prishtina-KH Vëllaznimi), Çlirim Rama (KH Rahoveci-KH Vëllaznimi), Alban Haziri (KH Rahoveci-KH Kastrioti), Olti Hoti (KH Prizreni-KH Istogu).

Konkurrenca e femrave:

Selviqe Mullakadria (KHF Besa-KHF Ferizaj), Agnesa Hysa (KHF Vushtrria-KHF Ferizaj), Learta Gashi (KHF Besa-KHF Tereza), Orgesa Gola (KHF Shqiponja-KHF Tereza), Schakira Robert Reinoso (Club Deportivo Escolapios-KHF Samadrexha), Blenarda Bytyqi (KHF Samadrexha-KHF Istogu), Gentiana Gashi (KHF Besa-KHF

Shqiponja), Ema Daija (KHF Vëllaznimi-KHF Shqiponja), Albulena Tërbunja (KHF KEK-u-KHF Prishtina).

Statusi i lirë:

(Mursel Mehmeti), (Perparim Kuqi), (Aurel Balaj), (Deniz Terziqi), (Vlerson Zherka), (Lulzim Shabani), (Ylli Visoka), (Rifat Visoka), (Jeton Bislimi), (Flakrim Beqiraj), (Rron Ramadani), (Hamdi Salihu), (Ardrin Dobraj), (Albios Beqiraj), (Behar Terziqi), (Albina Pllana), (Mirjeta Dinolli), (Shkurte Dinolli), (Marigona Dinolli), (Dorentina Qufaj), (Adelina Berisha), (Nikelina Franca), (Eduarta Kurteshi).

Sinner 'thyen' limitet, 50 milionë euro përfitime në vit

Bolzano, 16 korrik - Jannick Sinner jo vetëm është numër një në aspektin sportiv në tenis, e konfirmuar kjo pas suksesit të fundit në Wimbledon ndaj Carlos Alcaraz, por pritet të shndërrohet edhe në sportistin më të pasur pas përfitimeve që italianin pritet të marrë nga suksesi i turneut britanik. Jannick Sinner në një vit të artë si 2025, kur ai ka fituar Wimbledon, ka humbur për pak Roland Garros dhe ka triumfuar në Australian Open, vlerësohet se mund të përfitojë rreth 50 milionë euro brenda vitit. Një



shifër shumë e lartë, sidomos duke pasur parasysh që numri 1 i botës ka qenë i pezulluar për doping për tre muaj. Sipas "La Gazzetta dello Sport", Sinner ka 13 marrëveshje sponsorizimi, përfshirë: Nike, Gucci, Rolex,

Lavazza, Fastweb, Intesa Sanpaolo, Panini, Pigna, De Cecco, La Roche-Posay, Enervit. Këto kontrata i sjellin 30 milionë euro në vit (16 milionë nga sponsorët teknikë dhe 14 nga të tjerët). Shtu këtu edhe bonuset që varen nga rezultatet dhe fitimet nga produktet që mbajnë emrin e tij. Në vitin 2025 do të marrë pjesë edhe në një ndeshje demonstrative në Riad dhe, nëse vazhdon të fitojë, mund të shtojë edhe rreth 20 milionë euro të tjera, duke arritur në totalin prej 50 milionë eurosh për vitin.

Truproja e Messit: Leo më konsideron shok

I përzgjedhur nga David Beckham për ta mbrojtur Messin, Yassine Cheuko, ka dhënë një intervistë mjaft interesante së fundmi. Truproja e Messit, Cheuko, ka folur për raportin me gjenin e futbollit,

por jo vetëm. "Messi nuk më konsideron mua veç si truproje, por edhe si shok. Ne flasim, qeshim dhe e njohim personalitetin e njëri-tjetrit. Ai gjithmonë me fton në drekë dhe më trajton mjaft mirë. Kur ai e

fitoi Topin e Artë ishim të aeroplan dhe më tha: 'Yassine Carry, mbaje Topin e Artë në duart e tua!' I thashë: 'Ok...' Në fillim mendova se dëshiron të ia vendosja diku tjetër". Më pas, kur e mora trofeun, ai iu tha djemve

dhe gruas së tij: 'Fitues i Topit të Artë për bodyguard (sigurimin) më të mirë në botë është Yassin.' Ishte një moment i bukur dhe fjalë që s'do t'i harroj kurrë nga futbollisti më i mirë në botë. Ndihej si të isha pjesë e familjes

së tij dhe mundohem fort që ta mbroj jo vetëm në aspektin fizik, por edhe në atë psikologjik, sepse ai më beson shumë dhe sa më përket mua, unë jap gjithçka që ta kem krejt fokusin tek ai. Ai është mjaft kokulur dhe modest".

SHKURT

Zhegrova mund të largohet nga Lille, por mungon oferta konkrete

Edon Zhegrova mund të largohet nga Lille. Sipas asaj që shkruajnë mediet, për sulmuesin dardan nuk ka mbërritur ende ndonjë ofertë. Pavarësisht se interesimi nuk mungon, te Lille mungon një propozim zyrtar. Trajneri Bruno Genesio foli për këtë temë disa javë më parë në një konferencë për shtyp. "Lidhur me situatën e tij kontraktuale, besoj se atij i ka mbetur vetëm një vit deri në fund të sezonit, kështu që padyshim, në këto raste, shpesh ka dy zgjidhje: një zgjatje kontrate ose largim".

Reali konfirmon largimin e Vazquezit

Real Madridi ka njoftuar largimin e veteranit të klubit, Lucas Vazquez. Në një ceremoni lamtumirës, që do të mbahet të enjten më 17 korrik në Ciudad Real Madrid, do të jetë i pranishëm edhe presidenti Florentino Perez. Klubi ka shprehur mirënjohjen dhe dashurinë e tij për Lucas Vazquez, duke e cilësuar një nga legjendat e mëdha të historisë së tyre. Lucas Vazquez iu bashkua Real Madridit në vitin 2007, kur ishte vetëm 16-vjeçar, dhe kaloi në të gjitha kategoritë e akademisë, nga Juvenil C te Castilla. Pas një sezoni huazim tek Espanyol, ai debutoi me ekipin e parë në shtator 2015. Gjatë 10 viteve me Real Madridin ai ka luajtur në 402 ndeshje në një nga periudhat më të suksesshme të klubit. Në këtë kohë, Vazquezi ka fituar 23 trofe, duke përfshirë 5 Liga të Kampionëve, 5 Kupa Bote për Klube, 4 Superkupa Evropiane, 4 La Liga, 1 Kupë të Mbretit dhe 4 Superkupa Spanjolle.

Como e dëshiron Ronaldo

Cristiano Ronaldo mund të rikthehet në Serinë A. Como raportohet se është e interesuar për transferimin e yllit portugez, edhe pse ai është në fund të karrierës. Ronaldo, i cili aktualisht është pjesë e Al Nassrit në Arabinë Saudite, po jep maksimumin që ia lejon moshë 40-vjeçare. Trajneri i ekipit italian, Cesc Fabregas, ka ambicie të mëdha për sezonin e ri dhe po mendon rikthimin e Ronaldos në Serinë A, aty ku Como ka ambicie realisht të mëdha për të ardhmen.

PSG-ja largon 11 futbollistë

Humbja e thellë 3-0 ndaj Chelseas në finalen e Kupës së Botës për Klube ka sjellë pasoja të rënda te Paris Saint-Germaini. Sipas "Le Parisien", kampionët e Francës po planifikojnë një "pastrim" të thellë në skuadër, me 11 lojtarë që pritet të largohen gjatë kësaj vere. Në listën e parë të të larguarve bëjnë pjesë Milan Skriniar, Nordi Mukiele, Carlos Soler, Marco Asensio dhe Randal Kolo Muani, të gjithë emra që nuk janë më pjesë e planeve të trajnerit Luis Enrique dhe që kanë qenë në huazim. Por "revolucionin" nuk ndalet me kaq. Edhe futbollistë si Gabriel Moscardo, Lucas Hernandez, Lucas Beraldo, Kang-in Lee dhe Gonçalo Ramos janë në listën e pritjes, nëse vijnë ofertat e duhura për ta. Dilema më e madhe në kampin parisien mbetet portieri Gianluigi Donnarumma. Kontrata e italianit skadon në verën e vitit 2026 dhe deri tani nuk ka sinjale për rinovim. PSG nuk dëshiron të rrezikojë me largimin e tij si lojtar i lirë dhe është gati ta shesë këtë verë, sidomos duke parë interesin nga klube si Chelsea dhe Manchester City.

Truproja e Messit: Leo më konsideron shok

I përzgjedhur nga David Beckham për ta mbrojtur Messin, Yassine Cheuko, ka dhënë një intervistë mjaft interesante së fundmi. Truproja e Messit, Cheuko, ka folur për raportin me gjenin e futbollit,

por jo vetëm. "Messi nuk më konsideron mua veç si truproje, por edhe si shok. Ne flasim, qeshim dhe e njohim personalitetin e njëri-tjetrit. Ai gjithmonë me fton në drekë dhe më trajton mjaft mirë. Kur ai e

fitoi Topin e Artë ishim të aeroplan dhe më tha: 'Yassine Carry, mbaje Topin e Artë në duart e tua!' I thashë: 'Ok...' Në fillim mendova se dëshiron të ia vendosja diku tjetër". Më pas, kur e mora trofeun, ai iu tha djemve

dhe gruas së tij: 'Fitues i Topit të Artë për bodyguard (sigurimin) më të mirë në botë është Yassin.' Ishte një moment i bukur dhe fjalë që s'do t'i harroj kurrë nga futbollisti më i mirë në botë. Ndihej si të isha pjesë e familjes

së tij dhe mundohem fort që ta mbroj jo vetëm në aspektin fizik, por edhe në atë psikologjik, sepse ai më beson shumë dhe sa më përket mua, unë jap gjithçka që ta kem krejt fokusin tek ai. Ai është mjaft kokulur dhe modest".



KOLEGJI - COLLEGE

BIZNESI

Prishtinë

Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjibiznesi.com,

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878 info@kolegjibiznesi.com

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: 30.05.2025, të **Kolegjit “BIZNESI” Prishtinë dhe Dega në Prizren:**

Kolegji Biznesi shpall konkursin publik të rregullt për pranimin dhe regjistrimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2025/2026, në të gjitha programet e studimit të akredituara nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës dhe të licencuara nga MASHT.

Të drejtë aplikimi dhe regjistrimi në studimet themelore (Bachelor) e kanë të gjithë kandidatët që e kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë dhe që e kanë përfunduar me sukses testin kombëtar të maturës. Kurse ne studimet Master kanë të drejtë aplikimi dhe regjistrimi të gjithë kandidatët që i kanë përfunduar Studimet Bachelor.

Studime Bachelor
1.Banka dhe Financa në Biznes (Ba) - (3 Vjeçar)
2.Menaxhment dhe Ekonomiks (Ba) - (3 Vjeçar)
3.Menaxhimi i Emergjencave (Ba) - (3 Vjeçar)
4.Juridik / LLB - (4 Vjeçar)
5. Shkenca Kompjuterike Bsc - (3 Vjeçar)

Studime Master
1.Menaxhment dhe Financa – MA-(2 Vjeçar)
2.Menaxhimi i Emergjencave – MA-(2 Vjeçar)

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Bachelor, i bashkëngjisin aplikacionit:

- Certifikata e maturës shtetërore – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Diploma e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Dëftesat e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Ekstrakti i lindjes;
- Kopje e letërnjoftimit;
- 2 fotografi (formati pasaportë)

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Master, i bashkëngjisin aplikacionit:

- Diplomën ose certifikatën e fakultetit (të noterizuar)
- CV
- Certifikatën e lindjes
- Kopjen e letërnjoftimit
- Dy foto

038/045- 500 878 : 029-230-555

044/ 049/ 048- 500 – 878



KOLEGJI - COLLEGE

BIZNESI

Prishtinë

Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjibiznesi.com, info@kolegjibiznesi.com

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: **30.05.2025**, të Kolegjit “BIZNESI” Prishtinë:

SHPALL KONKURS PËR PRANIMIN E STAFIT AKADEMIK

I. PROFESORA

1. **Dy (2)** mësimdhënës në programin – **Ekonomik,**
2. **Dy (2)** mësimdhënës në programin – **Juridik,**
3. **Dy (2)** mësimdhënës në programin - **Menaxhimi i Emergjencave,**
4. **Një (1)** mësimdhënës në programin – **Shkenca Kompjuterike,**

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të **Kolegjit Biznesi.**

Për vendin e punës mësimdhënës, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar doktoratën në lëmin përkatëse dhe punime në revistat si SCOPUS dhe WEB OF SCIENCE.

Njohja e gjuhës angleze apo e ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për aplikantët.

Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet ti paraqesin këto dokumente: Kërkesën me biografi (CV), Kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar (vërtetuar), Certifikatën e lindjes, Kopjen e letërnjoftimit.

Kandidatët që kanë doktoruar jashtë vendit duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Konkursi mbetet i hapur nga **18.06.2025 deri më 30.06.2025.**

Paraqitja e dokumenteve: Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, 10000 Prishtinë, Kosovë ose përmes e-mail: info@kolegjibiznesi.com

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në web faqen: www.kolegjibiznesi.com

Aplikacionin mund ta shkarkoni në ueb faqen: www.kolegjibiznesi.com ose mund ta merrni në zyrat e Kolegjit Biznesi.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “ARGUMENTI” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812296425 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “ARGUMENTI” D.O.O. od Prishtinë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812296425 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “ARGUMENTI” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 812296425 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Shaban Morina shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore në Kushnin, Has, komuna e Prizrenit.

- Shkurte Morina shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Shtjefën Gjeqovi”, Zym i Hasit, Prizren.

- Binak Likaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës “Shtjefën Gjeqoni”, në Krajk-Has, Prizren.

- ARBNORA HALITI, shpall te pavlefshme diplomën e SHMLM “Dr. Xheladin Deda”.

- LEUTRIM ZYMERI, shpall te pavlefshme certifikatën e testit te maturës te SHMLM “Dr. Xheladin Deda”.

- ERMIRA MURSELI, shpall te pavlefshme certifikatën e testit te maturës te SHMLM “Dr. Xheladin Deda”.

- SPASENA RADOSAVLJEVIC B.I, shpall të humbur certifikatën e biznesit me numër unik identifikues: 810698631.

- Endrit Cena nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Sh.M.M. “Hysni Zajmi”, Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

